VENDIM
Nr. 35, datë 27.1.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË MJEKËVE, STOMATOLOGËVE DHE ARKITEKTËVE NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË MJEKËVE, STOMATOLOGËVE DHE ARKITEKTËVE NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (më poshtë bashkërisht "Palët" dhe individualisht "Pala"),

në kontekst të integrimit ekonomik, në përputhje me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore ("CEFTA") 2006, në përputhje me nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve, dhe për qëllime të mëtejshme të liberalizimit të tregtisë së shërbimeve brenda CEFTA-s;

duke pasur parasysh qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021–2024 ("CRM") që synon heqjen e pengesave për njohjen e kualifikimeve profesionale, përmes miratimit dhe zbatimit të një "Kuadri të Bashkimit Evropian (BE) për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale për shtatë profesione dhe sistemin e njohjes automatike të BE-së" bazuar në bashkërendimin e kushteve minimale të trajnimit;

duke vërejtur se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se i përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas traktateve ekzistuese;

me synim inkurajimin e lëvizshmërisë të profesionistëve, përputhjen më të mirë të aftësive me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e produktivitetit;

duke theksuar objektivat e promovimit të harmonizimit rregullator dhe përafrimit të ligjeve dhe rregulloreve të Palëve me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE); në veçanti duke synuar mundësimin e lëvizjes së lirë të profesionistëve përmes transpozimit në kuadrin rajonal të direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, të ndryshuar me *direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013*;

me synimin e sigurimit të njohjes automatike të kualifikimeve profesionale bazuar në kërkesat minimale të trajnimit dhe zbatimit të saj në të tri profesionet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe Direktivën e sipërpërmendur dhe të caktimit të profesioneve që plotësojnë zbatimin e kërkesave minimale të trajnimit brenda shtojcave në jo më shumë se dy vjet për ta shtrirë atë në katër profesione të tjera me miratimin e kësaj Marrëveshjeje;

Bien dakord si më poshtë:

* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje përcakton rregullat për njohjen automatike të dëshmive të kualifikimeve formale bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda Palëve për akses dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, si dhe kushtet minimale të harmonizuara të trajnimit në një ose më shumë Palëve të tjera, dhe që lejojnë mbajtësit e kualifikimit në fjalë (më poshtë: profesionistët) të ndjekin të njëjtin profesion në një Palë (më poshtë: Pala pritëse) të ndryshme nga Pala ku ata kanë marrë kualifikimet e tyre profesionale (më poshtë Pala lëshuese).

2. Termat e përdorur në këtë Marrëveshje që kanë një kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në gjininë mashkullore apo femërore, përfshijnë si gjininë mashkullore ashtu edhe atë femërore, dhe çdo gjini tjetër të njohur nga Palët.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për personat fizikë, siç përcaktohet në shtojcën I të protokollit shtesë 6, si profesionistë të Palës lëshuese që dëshirojnë të ndjekin një profesion të rregulluar në një Palë pritëse, në varësi të kushteve minimale të harmonizuara të trajnimit, qoftë për një të vetëpunësuar ose të punësuar. Secila Palë do të lejojë një profesionist të Palës lëshuese, me dëshmi të kualifikimeve profesionale dhe formale sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), të cilat nuk janë marrë në Palën pritëse, të ndjekë një profesion të rregulluar sipas kuptimit të nenit 3(1)(a) brenda një Palë e tillë në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e saj përkatës. Kjo njohje do të respektojë kushtet minimale të trajnimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Nëse dëshmitë e kualifikimit formal nuk janë në përputhje me kushtet minimale të trajnimit, siç parashikohen në këtë Marrëveshje, njohja e kualifikimit profesional do t'i nënshtrohet një sistemi të përgjithshëm njohjeje.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet për profesionistët e mëposhtëm: mjekët, stomatologët dhe arkitektët, siç përcaktohet dhe renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

3. Secila Palë do t'i paraqesë grupit të përbashkët të punës për njohjen e kualifikimeve profesionale ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që ajo miraton në lidhje me lëshimin e dëshmive të kualifikimeve formale në profesionet e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

4. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, institucionet e arsimit të lartë do të kenë programe studimi të akreditura dhe/ose programe studimi të licencuara të harmonizuara me kërkesat minimale të trajnimit të përcaktuara në shtojcat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "profesion i rregulluar": një veprimtari profesionale ose grup veprimtarish profesionale, qasja në të cilën, ndjekja e së cilës, ose një nga mënyrat e ndjekjes të së cilës është subjekt, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në bazë të dispozitave legjislative, rregullatore ose administrative, i kualifikimeve specifike profesionale; në veçanti, përdorimi i një titulli profesional të kufizuar nga dispozita legjislative, rregullatore ose administrative për mbajtësit e një kualifikimi të caktuar profesional do të përbëjë një mënyrë ndjekjeje (të profesionit);

b) "kualifikime profesionale": kualifikime të vërtetuara me dëshmi të kualifikimeve formale, një dëshmi kompetence e lëshuar nga një autoritet kompetent i Palës, i caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale, në bazë të një kursi trajnimi ose një provimi specifik dhe/ose përvojës profesionale;

c) "dëshmi e kualifikimeve formale": diploma, certifikata dhe dëshmi të tjera të lëshuara nga një autoritet i një Pale të caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale dhe që vërtetojnë përfundimin e suksesshëm të trajnimit profesional të marrë kryesisht në një Palë;

d) "autoritet kompetent": çdo autoritet ose organ i autorizuar nga një Palë në mënyrë specifike, për të lëshuar ose marrë diploma trajnimi dhe dokumente ose informacione të tjera, si dhe për të

marrë aplikimet dhe vendimet e përmendura në këtë Marrëveshje;

e) "arsim dhe trajnim i rregulluar": çdo trajnim i cili është i orientuar në mënyrë specifike për ndjekjen e një profesioni të caktuar dhe që përfshin një kurs ose kurse të plotësuara, sipas rastit, me trajnim profesional, ose praktikë provuese ose profesionale;

f) Struktura dhe niveli i formimit profesional, i periudhës së provës ose praktikës profesionale do të përcaktohet nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të Palës së interesuar ose të monitoruara ose të miratuara nga autoriteti i caktuar për këtë qëllim;

g) "përvojë profesionale": ndjekja aktuale dhe e ligjshme me kohë të plotë ose ekuivalente, me kohë të pjesshme të profesionit në fjalë në një Palë;

h) "praktikë profesionale": një periudhë praktike profesionale e kryer nën mbikëqyrje, me kusht që të japë akses në një profesion të rregulluar, që mund të ndodhë ose gjatë ose pas përfundimit të një arsimimi që çon në një kualifikim;

i) "person fizik" siç përcaktohet në kuadrin e CEFTA-s;

j) "Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive ose Krediteve ECTS": sistemi i krediteve për arsimin e lartë, i përdorur në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë;

k) Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP);

l) 'CEFTA': Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore;

m) 'RCC': Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Neni 4
Efektet e njohjes

Njohja e kualifikimeve profesionale nga Pala pritëse do t'i lejojë personat fizikë të kenë akses në atë Palë në të njëjtin profesion për të cilin ata janë të kualifikuar në Palën lëshuese dhe ta ushtrojnë atë në Palën pritëse në kushte jo më pak të favorshme sesa personat fizikë të saj.

KREU II
PARIMET E NJOHJES

Neni 5
Rregullat e lidhura me natyrën profesionale, ligjore ose administrative

Kur një profesionist lëviz, ai i nënshtrohet rregullave profesionale, ligjore ose administrative, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me kualifikimet profesionale, të tilla si përkufizimi i profesionit, përdorimi i titujve dhe abuzimi i rëndë profesional, i cili lidhet drejtpërdrejt dhe specifikisht me mbrojtjen dhe sigurinë e konsumatorit, si dhe dispozitat disiplinore që zbatohen në Palën pritëse për profesionistët që ndjekin të njëjtin profesion në Palën pritëse.

Neni 6
Parimet e njohjes automatike

1. Secila Palë do të njohë dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, duke dhënë akses në veprimtaritë profesionale të mjekut me trajnim bazë dhe si mjek i specializuar, si stomatolog dhe stomatolog i specializuar, dhe si arkitekt, të renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III, të cilët plotësojnë kushtet minimale të trajnimit të përmendura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III dhe për qëllime të aksesit dhe ndjekjes së veprimtarive profesionale, do t'i japin këtyre dëshmive të njëjtën fuqi, si dëshmive të kualifikimeve formale që lëshon vetë.

Dëshmi të tilla të kualifikimeve formale duhet të lëshohen nga organet kompetente të Palës lëshuese dhe të shoqërohen, sipas rastit, me certifikatat e renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

2. Këto përditësime nuk do të sjellin ndryshim të parimeve ekzistuese thelbësore ligjore të Palëve në lidhje me strukturën e profesioneve, si dhe në lidhje me trajnimin dhe kushtet e aksesit nga personat fizikë. Këto përditësime do të respektojnë përgjegjësinë e Palëve për organizimin e sistemeve arsimore.

Neni 7
Dispozitat e përbashkëta mbi trajnimin

Palët, në përputhje me procedurat specifike të secilës Palë, do të sigurojnë inkurajimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, që profesionistët, kualifikimi profesional i të cilëve mbulohet nga kjo Marrëveshje, të jenë në gjendje të përditësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre për të ruajtur një siguri dhe praktikë efektive dhe për t'u përditësuar për zhvillimet profesionale.

Neni 8
Të drejtat e fituara

Pa cenuar të drejtat e fituara, specifike për profesionet në fjalë, në rastet kur dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, të cilat japin akses në veprimtaritë profesionale të mjekut me formim bazë dhe mjekut të specializuar, si stomatolog dhe stomatolog i specializuar dhe si arkitekt që kanë profesionistët e Palëve, nuk plotësojnë të gjitha kërkesat për trajnim të përmendura në këtë Marrëveshje, secila Palë do të njohë si provë të mjaftueshme dëshminë e kualifikimeve formale të lëshuar nga këto Palë për aq sa kjo dëshmi vërteton përfundimin me sukses të trajnimit, që fillon në datat që do të propozohen nga Grupi i Përbashkët i Punës dhe shoqërohet me një certifikatë që deklaron se mbajtësit e tyre janë përfshirë efektivisht dhe ligjërisht në veprimtaritë në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë viteve para dhënies së certifikatës.

KREU III
PROCEDURA PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Neni 9
Procedura e përbashkët për njohjen e kualifikimeve profesionale

1. Pala pritëse do të njoftojë se e ka marrë kërkesën brenda 30 ditëve nga marrja e saj dhe do të informojë kërkuesin për çdo dokument që mungon. Nëse kërkuesi nuk e dorëzon dokumentacionin shtesë, autoriteti kompetent e refuzon kërkesën si të paplotë, përveç rastit kur kandidati argumenton arsyet për mosrespektimit të

2. Procedura për shqyrtimin e një kërkese për autorizim për të ushtruar një profesion të rregulluar duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të çojë në një vendim të arsyetuar siç duhet nga autoriteti kompetent në Palën pritëse, në çdo rast brenda tre muajve pas datës kur kërkuesi ka dorëzuar dosjen e plotë dhe në këto raste arsyet do të shpjegohen në vendimin e njohjes.

3. Vendimi ose mungesa e marrjes së një vendimi brenda afatit është objekt ankimi sipas rregullave të përgjithshme të secilës Palë.

Neni 10
Rekursi

Njohja e kualifikimeve profesionale do të përfshijë mundësinë për t'iu drejtuar një mekanizmi efektiv rekursi për kërkuesin. Në rast se nuk jepet njohja, kërkuesi duhet t'i drejtohet një autoriteti, i cili ka përbërje të ndryshme nga autoriteti që ka refuzuar kërkesën. Ky autoritet do të vendosë për ankesën pasi t'i ketë dhënë kërkuesit mundësinë për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme.

Neni 11
Dokumentet dhe Certifikatat që mund t'i kërkohen aplikantit në përputhje me këtë Marrëveshje

1. Dokumentet

a) Dëshmi se personi në fjalë është person fizik i një Pale.

b) Dëshmi të kualifikimeve formale që japin akses në profesionin e rregulluar në fjalë, siç ato renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

c) Dëshmi të kualifikimit profesional sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), shoqëruar me certifikatën e autoritetit kompetent që deklaron se profesionisti ka qenë i angazhuar efektivisht dhe ligjërisht në aktivitetet në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë vitet para dhënies së certifikatës.

d) Kur autoriteti kompetent i Palës pritëse kërkon, nga personat që dëshirojnë të ushtrojnë një profesion të rregulluar, prova se ata kanë karakter ose reputacion të mirë ose se nuk kanë shpallur falimentin, ose nuk janë pezulluar ose ndaluar të ushtrojnë profesionin në rast të abuzimit të rëndë profesional ose të një vepre penale, Pala pritëse përkatëse do të pranojë si provë të mjaftueshme, në lidhje me kërkuesit nga Palët që dëshirojnë të

ushtrojnë atë profesion, paraqitjen e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës lëshuese, të cilat tregojnë se këto kërkesa janë përmbushur. Këto autoritete duhet t'i ofrojnë dokumentet brenda një periudhe dymujore.

e) Kur autoritetet kompetente të Palës lëshuese nuk lëshojnë dokumentet e përmendura në nën paragrafin e parë, këto dokumente do të zëvendësohen me një deklaratë betimi ose, për Palët të cilat nuk kanë dispozitë për deklaratën e betimit, nga një deklaratë solemne, e bërë nga personi fizik në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ ose, sipas rastit, para organit profesional të kualifikuar të Palës lëshuese; ky autoritet lëshon një certifikatë që vërteton autenticitetin e deklaratës së betimit ose të deklaratës solemne.

f) Kur një Palë pranuese kërkon nga një profesionist i saj që dëshiron të ushtrojë një profesion të rregulluar, një dokument në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të kërkuesit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme paraqitjen e dokumentit të kërkuar në Pala lëshuese. Kur Pala lëshuese nuk lëshon një dokument të tillë, Pala pritëse do të pranojë një certifikatë të lëshuar nga një autoritet kompetent në atë Palë. Në këtë rast, autoritetet kompetente të Palës lëshuese duhet të japin dokumentin e kërkuar brenda një periudhe një mujore.

g) Kur një Palë pritëse kërkon që profesionistët të angazhohen në një profesion të rregulluar,

- provë të deklaratës së gjendjes financiare të kërkuesit,

- dëshmi që kërkuesi është i siguruar ndaj rreziqeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia profesionale e profesionistëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Palën pritëse në lidhje me kushtet dhe shtrirjen e mbulimit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme një vërtetim për këtë qëllim të lëshuar nga bankat dhe shoqëritë e sigurimit të një Pale tjetër.

Kur një Palë e kërkon këtë për profesionistët, do të sigurohet një vërtetim që konfirmon mungesën e pezullimeve të përkohshme ose përfundimtare nga ushtrimi i profesionit ose i dënimeve penale.

2. Certifikata të tjera

Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të përcaktojnë që, përveç dëshmive të kushtet e kërkuara të trajnimit, duhet të ofrojë një certifikatë nga autoritetet kompetente të tij/saj dhe çdo Palë tjetër lëshuese që deklaron se kjo dëshmi e kualifikimeve formale plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3. Formati dhe gjuha

Të gjitha dokumentet dhe certifikatat e përmendura në këtë nen do të pranohen nga autoriteti kompetent i Palës pritëse në formatin dhe gjuhën e përcaktuar në legjislacionin e Palës lëshuese. Pala pritëse ruan të drejtën për të kërkuar përkthimin e dokumenteve dhe certifikatave në një nga gjuhët e saj zyrtare prej kërkuesit.

Neni 12

Përdorimi i titujve profesionalë

1. Nëse, në një Palë pritëse, përdorimi i një titulli profesional në lidhje me një nga veprimtaritë e profesionit në fjalë është i rregulluar, kërkuesit nga Pala tjetër, të cilët janë të autorizuar për të ushtruar një profesion të rregulluar, do të përdorin titullin profesional të Palës pritëse, që përkon me atë profesion në atë Palë, dhe të përdorë çdo inicial shoqërues.

2. Kur një profesion është i rregulluar në Palën pritëse nga një shoqatë ose organizatë, kërkuesit nga Palët nuk do të autorizohen të përdorin titullin profesional të lëshuar nga ajo organizatë ose shoqatë, ose formën e tij të shkurtuar, përveç rasteve kur ata japin prova se janë anëtarë të shoqatës ose organizatës përkatëse.

3. Nëse shoqata ose organizata e kushtëzon anëtarësimin e kualifikimeve të caktuara, ajo mund ta bëjë këtë, vetëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në lidhje me kërkuesit e Palëve të tjera, të cilët kanë kualifikime profesionale.

Neni 13

Përdorimi i titujve akademikë

Pala pritëse do të sigurojë që personave fizikë të interesuar t'u jepet e drejta për të përdorur titujt akademikë që u janë dhënë në Palën lëshuese dhe një formë të shkurtuar të tyre, në gjuhën e Palës lëshuese. Pala pritëse mund të kërkojë që një titull të pasohet nga emri dhe adresa e dhënies ose e bordit shqyrtues që e ka dhënë atë. Kur një titull akademik i Palës lëshuese mund të ngatërrohet në Palën pritëse me një titull që, në Palën e fundit,

kërkon trajnim shtesë që nuk është marrë nga përfituesi, Pala pritëse mund t'i kërkojë përfituesit të përdorë titullin akademik të Palës lëshuese në një formë të përshtatshme, e cila do të përcaktohet nga Pala pritëse.

KREU IV
RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR NDJEKJEN E PROFESIONIT

Neni 14
Njohja e gjuhëve

1. Një Palë, nëse gjykohet e nevojshme, do të kërkojë nga ofruesi i shërbimit që përfiton nga njohja e kualifikimeve profesionale të ketë njohuri të mjaftueshme të gjuhëve të nevojshme për ushtrimin e profesionit në Palën pritëse.

2. Një Palë do të sigurojë që çdo kontroll i kryer për kontrollin e pajtueshmërisë me detyrimin sipas paragrafit 1 do të kufizohet te njohuritë e mjaftueshme të një gjuhe zyrtare të asaj Pale.

3. Çdo kontroll gjuhësor duhet të jetë proporcional me aktivitetin që do të kryhet. Profesionisti i interesuar do të lejohet të apelojë kontrolle të tilla sipas ligjit të Palës pritëse.

KREU V
BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 15
Aksesi qendror për informacion

1. Palët do të sigurojnë që informacioni i mëposhtëm të jetë i disponueshëm publikisht në gjuhën angleze dhe nëpërmjet pikave të kontaktit për shërbimet:

a) një listë të të gjitha profesioneve të rregulluara në atë Palë duke përfshirë detajet e personave të kontaktit për secilin profesion të rregulluar sipas nenit 18(4);

b) kërkesat dhe procedurat për të gjitha profesionet e rregulluara në atë Palë, duke përfshirë të gjitha tarifat përkatëse që duhet të paguhen nga personat fizikë dhe dokumentet që do të dorëzohen nga personat fizikë;

c) detaje se si të apelohen, sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, vendimet e Palëve të miratuara në lidhje me këtë

2. Palët do të sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të ofrohet në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm në distancë dhe me mjete elektronike dhe që të mbahet i përditësuar.

3. Palët do të sigurojnë që çdo kërkesë për informacion drejtuar pikave të kontaktit për shërbimet t'i përgjigjet sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 16
Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale

1. Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP) do të lehtësojë dhe mbikëqyrë zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Anëtarët e GPPNJKP-së, ndër të tjera, do të ngarkohen me dhënien e informacionit dhe asistencës siç është e nevojshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara në këtë Marrëveshje, të tilla si informacion mbi legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative që rregullojnë njohjen e kualifikimeve të profesionistëve.

3. Termat e referencës së GPPNJKP-së do të miratohen jo më vonë se një vit pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
Transparenca

1. Palët do t'i japin GPPNJKP-së një listë të të gjitha profesioneve ekzistuese të rregulluara, duke specifikuar veprimtaritë e mbuluara nga secili profesion, dhe një listë të arsimit dhe trajnimit të rregulluar, dhe trajnimit me një strukturë të posaçme, jo më vonë se 18 muaj pas miratimit të këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim në ato lista do t'i njoftohet gjithashtu GPPNJKP-së pa vonesa të panevojshme. Sekretariatet e CEFTA-s dhe RCC-së do të krijojnë dhe mbajnë një bazë të dhënash publike të profesioneve të rregulluara, duke përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarive të mbuluara nga secili profesion.

2. Palët do të shqyrtojnë nëse kërkesat sipas sistemit të tyre ligjor kufizojnë aksesin në një profesion ose ndjekjen e tij për mbajtësit e një kualifikimi specifik profesional, duke përfshirë

përdorimin e titujve profesionalë dhe aktivitetet profesionale të lejuara sipas këtij titulli, të përmendura në këtë nen si "kërkesat" janë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) kërkesat nuk duhet të jenë as drejtpërdrejt as tërthorazi diskriminuese;

b) kërkesat duhet të justifikohen nga arsye kryesore të interesit të përgjithshëm;

c) kërkesat duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar arritjen e objektivit të ndjekur dhe nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur atë objektiv;

d) Palët do të informojnë GPPNJKP-në për gjetjet e tyre.

Neni 18
Parimet e bashkëpunimit administrativ

1. Palët do të punojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe do të ofrojnë ndihmë reciproke për të lehtësuar zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Ato duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit që shkëmbejnë.

2. Nëpërmjet GPPNJKP-së, Palët do të shkëmbejnë informacionin që ata e gjykojnë të nevojshëm për ndjekjen e veprimtarive sipas kësaj Marrëveshjeje. Duke vepruar kështu, ato do të respektojnë rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në legjislacionin përkatës të Palëve.

3. Secila Palë do të shkëmbejë informacion me Palët e tjera nëpërmjet GPPNJKP-së mbi proceset me anë të së cilave ato do të japin ose marrin dëshmi të kualifikimeve formale dhe dokumente ose informacione të tjera, dhe do të marrin kërkesa dhe marrin vendimet e përmendura në këtë Marrëveshje.

4. Nëpërmjet GPPNJKP-në, secila Palë do t'u sigurojë Palëve të tjera emrin e një personi kontakti për secilin profesion të rregulluar, i cili do të sigurojë të gjithë informacionin përkatës dhe do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet Palëve në lidhje me profesionin e rregulluar specifik përkatës.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Transpozimi

1. Palët do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Marrëveshje jo më vonë se tetëmbëdhjetë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 21 të saj. Palët do të informojnë GPPNJKP-në për këtë.

Neni 20
Shtojcat

1. Të gjitha shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Informacioni që duhet të ofrohet nga Palët në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III do të sigurohet nga autoritetet kompetente dhe do t'i dorëzohet GPPNJKP-së jo më vonë se 18 muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, sipas nenit 21 të saj.

3. Palët do të sigurojnë që informacioni i dhënë në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III të mbahet i përditësuar dhe të ndryshohet sipas nevojës nga GPPNJKP-ja në përputhje me nenin 6(1)(2) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni përkatës i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohet te Depozitari.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të njoftimit të tretë formal të ratifikimit, pranimit ose miratimit për Palët që kanë depozituar njoftimin e tyre formal të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Për çdo Palë që depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas ditës në të cilën Pala përkatëse depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

4. Maqedonia e Veriut do të veprojë si Depozitar dhe do të njoftojë të gjitha palët në këtë Marrëveshje për çdo njoftim të marrë në përputhje me këtë nen dhe çdo akt ose njoftim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 22
Ndryshimet

1. Secila Palë mund të propozojë ndryshime të Marrëveshjes duke i dërguar një njoftim me shkrim Depozitarit. Depozitari do t'ia referojë këtë njoftim GPPNJKP-së si përmendur në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Propozimet e ndryshimeve do të miratohen me konsensus të të gjithë anëtarëve të GPPNJKP-së. Këto propozime do t'i referohen organit përgjegjës të CEFTA-s për tregtinë e shërbimeve.

3. Kur të miratohen, ndryshimet do t'u paraqiten Palëve për ratifikim ose miratim.

4. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në nenin 21.

Neni 23
Kohëzgjatja dhe denoncimi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe.

2. Çdo Palë, në çdo kohë, mund të denoncojë Marrëveshjen duke i bërë një njoftim me shkrim Depozitarit, i cili do të njoftojë Palët e tjera për këtë denoncim.

3. Ky denoncim do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës kur njoftohet Depozitari.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga kjo Marrëveshje do të zgjidhen përmes Mekanizmit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve CEFTA 2006.

Neni 25
Aderimi nga Palët e CEFTA-s

Palët njohin të drejtat e çdo Pale të CEFTA-s për aderim në këtë Marrëveshje.

Marrëveshja hartohet në gjuhën angleze në versionin origjinal, që do të mbetet në zotërim të Depozitarit. Secila Palë do të marrë një kopje të verifikuar të Marrëveshjes.

Nënshkruar në _____, më _____ 2022

[*Nënshkrimet*]

Shtojcat:

Njohja në bazë të koordinimit të kushteve minimale të trajnimit

MJEK

Neni 1
Trajnimi mjekësor bazë

1. Pranimi në trajnimin bazë mjekësor do të jetë i kushtëzuar me zotërimin e një kualifikimi ose certifikate që siguron akses, për studimet në fjalë, në universitete.

2. Trajnimi bazë mjekësor do të përfshijë gjithsej të paktën pesë vite studimi, të cilat mund të shprehen gjithashtu me kredite ekuivalente ECTS, dhe do të përbëhet nga të paktën 5 500 orë trajnim teorik dhe praktik të ofruar nga ose nën mbikëqyrjen të një universiteti.

3. Trajnimi bazë mjekësor do të japë siguri që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme

a) njohuri të përshtatshme për shkencat mbi të cilat bazohet mjekësia dhe kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;

b) kuptim të mjaftueshëm të strukturës, funksioneve dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore;

c) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe praktikat klinike, duke i siguruar atij një pasqyrë koherente të sëmundjeve mendore dhe fizike, të mjekësisë nga pikëpamja e profilaksisë, diagnostikimit dhe terapisë dhe riprodhimit njerëzor;

d) përvojë të përshtatshme klinike në spitale nën mbikëqyrjen e duhur.

Neni 2
Trajnimi i specializuar mjekësor

1. Pranimi në trajnimin mjekësor të specializuar do të kushtëzohet me përfundimin dhe vlefshmërinë e një programi të trajnimit bazë mjekësor, siç përmendet në nenin 1 të shtojcës I, gjatë të cilit kursanti ka marrë njohuritë përkatëse të mjekësisë bazë.

2. Trajnimi i specializuar mjekësor do të përfshijë trajnimin teorik dhe praktik në një spital universitar ose mësimor mjekësor ose, kur është e përshtatshme, një institucion kujdesi mjekësor të miratuar për këtë qëllim nga autoritetet ose organet kompetente.

Palët do të sigurojnë që kohëzgjatja minimale e kurseve të trajnimit mjekësor të specializuar, sipas nenit 7 të shtojcës I, të mos jetë më e vogël se kohëzgjatja e parashikuar në atë pikë. Trajnimi do të bëhet nën mbikëqyrjen e autoriteteve ose organeve kompetente. Ai do të përfshijë pjesëmarrjen personale të praktikanti si mjek i specializuar në veprimtarinë dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga shërbimet në fjalë.

Trajnimi do të jepet me kohë të plotë në institucione specifike të njohura nga autoritetet kompetente. Ai përfshin pjesëmarrjen në të gjithë gamën e aktiviteteve mjekësore të departamentit ku zhvillohet trajnimi, duke përfshirë gatishmërinë, në mënyrë të tillë që specialisti praktikant t'i kushtojë të gjithë veprimtarinë e tij profesionale trajnimit të tij praktik dhe teorik gjatë gjithë javës së punës dhe gjatë gjithë vitit, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga autoritetet kompetente. Prandaj, këto poste do t'i nënshtrohen shpërblimit të duhur.

3a. Palët mund të parashikojnë, në legjislacionin përkatës, përjashtime të pjesshme nga pjesët e kurseve të trajnimit mjekësor të specializuar të renditura në nenin 7 të shtojcës I, që do të zbatohen rast pas rasti me kusht që kjo pjesë e trajnimit të jetë ndjekur tashmë gjatë një tjetër kursi trajnimi të specializuar të renditur në nenin 7 të shtojcës I, për të cilin profesionisti ka marrë tashmë kualifikimin profesional në një Palë. Palët do të sigurojnë që përjashtimi i dhënë të barazohet me jo më shumë se gjysmën e kohëzgjatjes minimale të kursit të trajnimit mjekësor të specializuar në fjalë.

Secila Palë do të njoftojë Komitetin Shumëpalësh dhe Palët e tjera për legjislacionin e

4. Palët do të kushtëzojnë lëshimin e dëshmive të trajnimit mjekësor të specializuar pas paraqitjes së dëshmisë së trajnimit bazë mjekësor të përmendur në nenin 7 të shtojcës I.

Neni 3
Llojet e trajnimit të specializuar mjekësor

Dëshmia e kualifikimeve formale si mjek i specializuar është dëshmi e tillë e dhënë nga autoritetet ose organet kompetente, siç korrespondon, për trajnimin e specializuar në fjalë, me titujt në përdorim në Palët e ndryshme dhe të përmendura në nenin 7 të shtojcës I.

Neni 4
Trajnimi i posaçëm në mjekësinë e përgjithshme

1. Pranimi në trajnim specifik në mjekësinë e përgjithshme do të kushtëzohet me përfundimin dhe vlefshmërinë e një programi të trajnimit bazë mjekësor, siç përmendet në nenin 1 të shtojcës I, gjatë të cilit praktikanti ka marrë njohuritë përkatëse të mjekësisë bazë.

2. Trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme që çon në dhënien e dëshmive të kualifikimeve formale të lëshuara përpara [1 janarit 2006] do të zgjasë të paktën dy vjet me kohë të plotë. Në rastin e dëshmive të kualifikimeve formale të lëshuara pas kësaj date, trajnimi do të zgjasë të paktën tre vjet me kohë të plotë.

Kur programi i trajnimit i përmendur në nenin 1 të shtojcës I përfshin trajnim praktik të dhënë nga një spital i miratuar që disponon pajisje dhe shërbime të përshtatshme mjekësore të përgjithshme ose si pjesë e një praktike të përgjithshme mjekësore të miratuar ose një qendre të miratuar ku mjekët ofrojnë kujdes parësor mjekësor, kohëzgjatja e trajnimi praktik mund të përfshihet, deri në maksimumi një vit, në kohëzgjatjen e parashikuar në nënparagrafin e parë për certifikatat e trajnimit të lëshuara më ose pas [1 janarit 2006].

Opsioni i parashikuar në nënparagrafin e dytë do të jetë i disponueshëm vetëm për Palët në të cilat trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme zgjat dy vjet që nga [1 janari 2001].

3. Trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme

autoriteteve ose organeve kompetente. Ai do të jetë më shumë praktik sesa teorik.

Trajnimi praktik do të ofrohet, nga njëra anë, për të paktën gjashtë muaj në një spital të miratuar që disponon pajisje dhe shërbime të përshtatshme dhe, nga ana tjetër, për të paktën gjashtë muaj si pjesë e një praktike të përgjithshme mjekësore të miratuar ose një qendër e miratuar ku mjekët ofrojnë kujdes parësor shëndetësor.

Trajnimi praktik do të zhvillohet në bashkëpunim me institucione apo struktura të tjera shëndetësore që kanë të bëjnë me mjekësinë e përgjithshme. Megjithatë, pa paragjykuar periudhat minimale të përcaktuara në nënparagrafin e dytë, trajnimi praktik mund të ofrohet gjatë një periudhe jo më shumë se gjashtë mujore në institucione ose struktura të tjera shëndetësore të miratuara që kanë të bëjnë me mjekësinë e përgjithshme.

Trajnimi kërkon pjesëmarrjen personale të profesionistit në veprimtarinë profesionale dhe përgjegjësitë e personave me të cilët ai punon.

4. Palët do të sigurojnë që lëshimi i dëshmive të kualifikimeve formale në praktikën e përgjithshme mjekësore të bëhet pas zotërimit të dëshmive të kualifikimeve formale në trajnimin bazë mjekësor të përmendur në nenin 6 të shtojcës I.

5. Palët mund t'i japin dëshmi të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I një mjeku që nuk ka kryer trajnimin e parashikuar në këtë nen, por që ka kryer një trajnim tjetër, plotësues, siç vërtetohet nga dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara nga autoritetet kompetente. Megjithatë, ato nuk mund të japin dëshmi të kualifikimeve formale, përveç nëse vërtetojnë njohuri të një niveli cilësisht të barabartë me njohuritë e marra nga trajnimi i parashikuar në këtë nen.

Palët do të përcaktojnë, *inter alia*, shkallën në të cilën trajnimi plotësues dhe përvoja profesionale e fituar tashmë nga kërkuesi mund të zëvendësojë trajnimin e parashikuar në këtë nen.

Palët mund të lëshojnë vetëm dëshmitë e kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I, nëse kërkuesi ka fituar të paktën gjashtë muaj përvojë të mjekësisë së përgjithshme në një praktikë mjekësore të përgjithshme ose në një qendër ku mjekët ofrojnë kujdes shëndetësor parësor të llojeve të përmendura në paragrafin 3.

Neni 5

Ndjekja e aktiviteteve profesionale të mjekëve të përgjithshëm

Secila Palë do të kushtëzojë ndjekjen e veprimtarive të një mjeku të përgjithshëm në kuadrin e sistemit të saj të brendshëm të sigurimeve shoqërore me zotërimin e dëshmive të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Palët mund të përjashtojnë nga ky kusht personat që aktualisht po ndjekin trajnime specifike në mjekësi të përgjithshme.

Neni 6

Dëshmitë e kualifikimeve formale në trajnimet mjekësore bazë

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep kualifikimet	Certifikata shoqëruese e kualifikimeve	Data e referencës

Neni 7

Dëshmitë e kualifikimeve formale të mjekëve të specializuar

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep kualifikimet	Data e referencës

Neni 8

Titujt e kurseve të trajnimit në mjekësi të specializuar

	Titulli	Titulli
Pala	Anestezi	Kirurgji e përgjithshme
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji neurologjike	Obstetri dhe gjinekologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Mjekësi e Përgjithshme (internale)	Oftalmologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Otorinolaringologji	Pediatri
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	
Pala	Mjekësi respiratore	Urologji
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Ortopedi	Anatomi patologjike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Neurologji	Psikiatri
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Radiologji diagnostikuese	Radioterapi
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji plastike	Biologji klinike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Mikrobiologji-bakteriologji	Biologji kimike
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Imunologji	Kirurgjia e kraharorit
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Pediatri	Kirurgji vaskulare
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Kardiologji	Gastroenterologji
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Reumatologji	Hematologji e Përgjithshme
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Endokrinologji	Fizioterapi
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite

Pala	Neuropsikiatri	Dermato-venerologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Radiologji	Psikiatri për fëmijët
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Geriatri	Sëmundjet e veshkave
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Sëmundjet e transmetueshme	Mjekësia e komunitetit
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Farmakologjia	Mjekësia e punës
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Alergologji	Mjekësi bërthamore
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgjia Maksilo-faciale (trajnim bazë mjekësor)	Hematologji biologjike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Stomatologji	Dermatologji
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Venerologji	Mjekësi tropikale
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji gastroenterologjike	Aksidentet dhe urgjenca
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Neurofiziologji klinike	Kirurgjia dentare, orale dhe maksilo-faciale (trajnime bazë mjekësore dhe dentare)
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

	Titulli	Titulli
Pala	Onkologji	Gjenetikë mjekësore
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

Neni 9

Dëshmi të kualifikimeve formale të mjekut të përgjithshëm

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Titulli profesional	Data e referencës

SHTOJCA II
STOMATOLOGËT

Të gjitha dispozitat në shtojcën I janë marrë nga direktiva e BE-së 2005/36/EC për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Neni 1
Trajnimi stomatologjik bazë

1. Pranimi në trajnimin bazë stomatologjik presupozon zotërimin e një diplome ose certifikate që jep akses, për studimet në fjalë, në universitete ose institute të larta të një niveli të njohur si ekuivalent në një Palë.

2. Trajnimi bazë stomatologjik përfshin gjithsej të paktën pesë vite studimi, të cilat mund të shprehen edhe me kreditë ekuivalente ECTS, dhe do të përbëhet nga të paktën 5 000 orë trajnime teorike dhe praktike me kohë të plotë që përfshin të paktën programin e përshkruar në nenin 4 të shtojcës II dhe që ofrohet në një universitet, në një institut të lartë që ofron trajnime të njohura si të një niveli ekuivalent ose nën mbikëqyrjen e një universiteti.

3. Trajnimi bazë stomatologjik do të sigurojë që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri të përshtatshme të shkencave mbi të cilat bazohet stomatologjia dhe një kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;

b) njohuri të përshtatshme për strukturën, fiziologjinë dhe sjelljen e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe ndikimin e mjedisit natyror dhe social në gjendjen e shëndetit të njeriut, për aq sa këta faktorë ndikojnë në stomatologji;

c) njohuri të përshtatshme për strukturën dhe funksionin e dhëmbëve, gojës, nofullave dhe të lidhura me to indet, të shëndetshme dhe të sëmura, dhe marrëdhëniet e tyre me gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe me mirëqenien fizike dhe sociale të pacientit;

d) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe metodat klinike, duke i ofruar dentistit një pamje koherente të anomalive, lezioneve dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve të lidhura me to dhe të stomatologjisë parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike;

e) përvojë e përshtatshme klinike nën mbikëqyrjen e duhur.

Ky trajnim do t'i sigurojë atij aftësitë e nevojshme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve që përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve shoqëruese.

Neni 2
Trajnimi i specializuar stomatologjik

1. Pranimi në trajnimin stomatologjik të specializuar varet nga përfundimi dhe vlefshmëria e trajnimit bazë stomatologjik të përmendur në nenin 1 të shtojcës II.

2. Trajnimi stomatologjik i specializuar përfshin mësime teorike dhe praktike në një qendër universitare, në një qendër trajtimi mësimore dhe kërkimore ose, sipas rastit, në një institucion shëndetësor të miratuar për këtë qëllim nga autoritetet ose organet kompetente.

Kurset e specializuara stomatologjike me kohë të plotë do të zgjasin të paktën tre vite dhe do të mbikëqyren nga autoritetet ose organet kompetente. Ato përfshijnë pjesëmarrjen personale të praktikantit si mjek stomatolog në veprimtarinë dhe në përgjegjësitë e institucionit përkatës.

3. Palët do të kushtëzojnë lëshimin e dëshmive të trajnimit stomatologjik të specializuar me zotërimin e dëshmive të trajnimit bazë stomatologjik të përmendur në nenin 5 të shtojcës II.

Neni 3
Ndjekja e veprimtarive profesionale të mjekëve stomatologë

1. Për qëllimet e kësaj direktive, veprimtaritë profesionale të mjekëve stomatologë janë veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 3 dhe të ndjekura sipas kualifikimeve profesionale të renditura në nenin 5 të shtojcës II.

2. Profesioni i mjekut stomatolog bazohet në trajnimin stomatologjik të përmendur në nenin 1 dhe 2 të shtojcës II dhe përbën një profesion specifik, i cili dallon nga profesionet e tjera të përgjithshme ose të specializuara mjekësore. Ndjekja e veprimtarive të një mjeku stomatolog

kërkon zotërimin e dëshmive të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 5 të shtojcës II.

3. Palët do të sigurojnë që mjekët stomatologë të jenë në përgjithësi në gjendje të kenë akses dhe të ndjekin aktivitetet e parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit të anomalive dhe sëmundjeve që prekin dhëmbët, gojën, nofullat dhe indet fqinje, duke pasur parasysh dispozitat dhe rregullat e etikës profesionale në datat e referencës të përmendura në nenin 5 të shtojcës II.

Neni 4

Programet e studimit për mjekët stomatologë

Programi i studimeve që çon në evidentimin e kualifikimeve formale në stomatologji duhet të përfshijë të paktën lëndët e mëposhtme. Një ose më shumë nga këto lëndë mund të mësohen në kontekstin e disiplinave të tjera ose në lidhje me to.

A. Lëndët bazë	B. Lëndët mjeko-biologjike dhe lëndët e mjekësisë së përgjithshme	C. Lëndët e lidhura drejtpërdrejt me stomatologjinë
— Kimi — Fizikë — Biologji	— Anatomi — Embriologji — Histologji, përfshirë citologjinë — Fiziologji — Biokimi (ose kimi fiziologjike) — Anatomi patologjike — Patologji e Përgjithshme — Farmakologji — Mikrobiologji — Higjienë — Mjekësi parandaluese dhe epidemiologji	— Protetodonci — Materiale dhe pajisje dentare — Stomatologji konservative — Stomatologji parandaluese — Anestezi dhe sedatimi — Kirurgji gojore — Patologji speciale — Praktik; klinike — Paedodontikë — Ortodonti — Periodonti — Radiologjia dentare
	— Radiologji — Fizioterapi — Kirurgji e Përgjithshme — Mjekësi e Përgjithshme, përfshirë Pediatrinë — Oto-rino-laringologji	— Okluzion dentar dhe funksioni i nofullës — Organizimi profesional, etika dhe legjislacioni — Aspektet sociale të praktikës dentare - Kirurgji maksimo-faciale

	— Derma-venerologji — Psikiatri i Përgjithshme — Psikoterapi — Neuropatologji — Anestezi	

Neni 5

Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të stomatologëve

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Certifikata që shoqëron dëshmitë e kualifikimeve	Titulli profesional	Data e referencës

Neni 6

Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të stomatologëve të specializuar

Kirurgjia orale

Pala	Dëshmitë zyrtare të kualifikimeve	Certifikata që shoqëron dëshmitë e kualifikimeve	Data e referencës

Ortodontia

Pala	Dëshmitë zyrtare të kualifikimeve	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Data e referencës

SHTOJCA III
ARKITEKTI

Neni 1
Trajnimi i arkitektëve

1. Trajnimi si arkitekt duhet të përfshijë:

a) një total prej të paktën pesë vitesh studimi me kohë të plotë në një universitet ose një institucion të krahasueshëm mësimor, që çon në përfundimin me sukses të një provimi të nivelit universitar; ose

2. Arkitektura duhet të jetë komponenti kryesor i studimit të përmendur në paragrafin 1. Studimi duhet të mbajë një ekuilibër midis aspekteve teorike dhe praktike të trajnimit mbi arkitekturën dhe të garantojë të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të mëposhtme:

b) aftësive për të krijuar dizajne arkitekturore që plotësojnë kërkesat estetike dhe teknike;

c) njohuri të përshtatshme mbi historinë dhe teoritë e arkitekturës dhe të arteve, teknologjive dhe shkencave njerëzore përkatëse;

d) njohjen e arteve të bukura si ndikim në cilësinë e dizajnit arkitekturor;

e) njohuri të përshtatshme për projektimin urban, planifikimin dhe aftësitë e përfshira në procesin e planifikimit;

f) të kuptuarit e marrëdhënieve midis njerëzve dhe ndërtesave, dhe midis ndërtesave dhe mjedisit të tyre, dhe nevojës për të lidhur ndërtesat dhe hapësirat ndërmjet tyre me nevojat njerëzore dhe shkallën;

g) të kuptuarit e profesionit të arkitektit dhe rolit të arkitektit në shoqëri, veçanërisht për përgatitjen e informacioneve që marrin parasysh faktorët social;

h) të kuptuarit e metodave të hetimit dhe përgatitjes së informimit për një projekt projektimi;

i) të kuptuarit e projektimit strukturor dhe problemeve ndërtimore dhe inxhinierike që lidhen me projektimin e ndërtesave;

j) njohuri të përshtatshme të problemeve fizike dhe teknologjive dhe të funksionit të ndërtesave për t'u siguruar atyre kushte të brendshme të rehatshme dhe mbrojtje kundër kushteve klimatike, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm;

k) aftësitë e nevojshme të projektimit për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të ndërtesave brenda kufizimeve të vendosura nga faktorët e kostos dhe rregulloret e ndërtimit;

l) njohuri të përshtatshme për industritë, organizatat, rregulloret dhe procedurat e përfshira në përkthimin e koncepteve të projektimit në ndërtesa dhe integrimin e planeve në planifikimin e përgjithshëm;

3. Numri i viteve të studimit akademik të përmendur në paragrafin 1 mund të shprehet edhe me kreditet ekuivalente ECTS.

Neni 2
Ndjekja e veprimtarive profesionale të arkitektëve

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, aktivitetet profesionale të një arkitekti janë aktivitetet që kryhen rregullisht nën titullin profesional të "arkitektit".

Neni 3
Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të arkitektëve

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Certifikate shoqëruese e dëshmive të kualifikimit	Viti akademik i referencës